

Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Albanian Residency” sh.p.k.

Sot, më datë 10/10/2023, i poshtëshënuari:

Eduard Prodani, i datëlindjes 18.06.1963 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Leternjoftim ID, me numër personal G30618108D,

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (*i ndryshuar*) dhe legjislatacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë shoqërinë tregtare të emërtuar “Albanian Residency” sh.p.k.

KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1

Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emërtimi tregtar i shoqërisë është “Albanian Residency” sh.p.k.

Shoqëria “Albanian Residency” sh.p.k është një person juridik privat, i themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (*i ndryshuar*) (*me pas referuar si “Ligji Tregtar”*), në formën e shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.).

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (*me pas referuar si “QKB”*) në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, shoqëria bëhet përgjegjëse kundrejt palëve të treta, për detyrimet dhe dëmet që shkakton gjatë veprimtarisë së saj.

Ortakët e shoqërisë do të janë përgjegjës kundrejt palëve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Neni 2

Selia

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën e mëposhtme:

Rr. “Arkitekt Sinani”, Nd. 56, H.10, Ap. 36, Njësia Administrative Nr. 3, 1005 Tiranë.

Neni 3

Objekti



Shoqëria ka si qëllim kryesor të ofrojë shërbime dhe ndihmë për investitorët dhe bizneset e huaja që dëshirojnë të zgjedhin Shqipërinë si vendin e tyre të preferuar për veprimitarë e biznesit, investimet dhe jetesën.

Fushat kryesore të veprimitarisë së shoqërisë sonë përfshijnë:

- Nxitje dhe asistencë për qytetaret, investitorët dhe bizneset e huaja për të zgjedhur Shqipërinë si vendin e tyre të preferuar për aktivitetin e biznesit dhe investimet.
- Asistencë në regjistrimin apo transferimin e operacioneve të biznesit të kompanive të huaja në Shqipëri.
- Asistencë për marrje leje qëndrimi dhe shtetësi në Republikën e Shqiperisë
- Asistencë në gjetjen dhe blerjen e pronave të patundshme, pasurive dhe investimeve të tjera në territorin shqiptar.
- Asistencë për klientët për të gjetur vendbanime të përshtatshme, vende pune dhe kushte të tjera të nevojshme për të jetuar dhe punuar në Shqipëri.
- Zhvillimi dhe organizimi i ngjarjeve dhe aktivitetave të ndryshme me qëllim të promovimit të cilësive të Shqipërisë në nivel ndërkombëtar.
- Përgatitja dhe zhvillimi i planeve të biznesit, raporteve mbi situatën ekonomike, studimeve të mundshme të fizibilitetit (feasibility studies), dhe analizave të tjera në mbështetje të investitorëve dhe bizneseve të huaja që dëshirojnë të investojnë në Shqipëri.
- Ofrimi i çdo lloji tjetër të shërbimeve të nevojshme për të realizuar qëllimet dhe objektivat e kompanisë sonë në përputhje me ligjin dhe rregulloret e aplikueshme në Shqipëri.
- Asistencë në marrjen e licencave dhe dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e klientëve sipas ligjit te në përputhje me ligjin shqiptar.
- Asistence juridike dhe shërbime të tjera të lidhura me kuadrin ligjor te Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme së Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI II

KAPITALI – KUOTAT

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 lekë (njëqind lekë). Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë, e zotëruar 100 % e kapitalit nga ortaku Z. Eduard Prodani, e paguar në përputhje me kuotën e tij.

Ortaku është përgjegjës kundrejt palëve të treta për humbjen që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



Kapitali Themeltar mund tē zmadhohet ose zvogëlohet me vendim tē Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6

Kuotat

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura

Çdo kuotë i jep zotërueshet tē drejtën e një vote.

Pronësia mbi kuotat do tē regjistrohet në regjistrin e ortakëve që do tē mbahet në selinë e Shoqërisë nën përgjegjësinë e Administratorit (“Regjistri i Ortakëve”).

Neni 7

Transferimi i Kuotave

Kuotat janë lirisht tē transferueshme nëpërmjet:

- Trashëgimisë;
- Shitblerjes;
- Dhurimit;
- Çdo mënyre tjetër tē parashikuar me ligj.

Kalimi i tē drejtave tē pronësisë, vënia peng, barrë apo çdo mjet tjetër sigurimi mbi kuotat do tē kërkojë, në mënyrë që tē prodhojë efekt, miratimin paraprak tē Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila vendos me shumicë tē thjeshtë.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 tē ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit tē kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund tē zmadhohet, me vendim tē Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, nëpërmjet emetimit tē kuotave tē reja ose rritjes së vlerës nominale tē atyre ekzistuese ose në çdo formë tjetër tē parashikuar nga Ligji.

Për çdo zmadhim kapitali tē Shoqërisë nëpërmjet emetimit tē kuotave tē reja, Ortaku do tē ketë tē drejtën e parablerjes pér nënshkrimin e këtyre kuotave tē reja tē emetuara. Çdo kuotë e re që nuk është blerë nga Ortaku gjatë këtij procesi, i ofrohet çdo pale tē tretë.

Kuotat e reja që do tē shlyhen si më parë në dorë, ashtu edhe në natyrë, do tē paguhen në përputhje me vendimin përkatës pér zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin pér Shoqërinë Tregtare.

Neni 9

Zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali mund tē zvogëlohet, me vendim tē Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me Ligjin pér Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë i Shoqërisë, i cili, veç kompetencave të tjera sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- përcaktimi i politikave tregtare;
- ndryshime të Statutit;
- emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- miratimi i skemës së shpërblimeve për administratorin;
- miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykime;
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- miratimin e rregullave të zbatueshme procedurale të mbledhjeve të saj;
- çështje të tjera sipas parashikimeve të këtij Statuti.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky statut dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.

Nëse Shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetëm.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të thirret nga Administratori dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaku.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratori, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Në rastin e vendimeve të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse është i pranishëm ose i përfaqësuar Ortaku që zotëroi më shumë se 30% (tridhjetë përqind) te kapitalit themeltar. Ne këto raste Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve do të marrë vendime me shumicën e votave te kapitalit pjesëmarrës, veç kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar dhe/ose ky Statut.

Për çështje, të cilat kërkojnë shumice te kualifikuar, si ndryshimi i Statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit, shpërndarja e fitimit, ristrukturimi dhe prishja e Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë te pranishëm ose te përfaqësuar

Ortaket që zoterojnë më shumë se 50% (pesëdhjete përqind) të kapitalit te regjistruar dhe do te marre vendime me $\frac{3}{4}$ (tre te katërtat) e votave te kapitalit pjesëmarrës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve nuk mund të mblidhet për shkak te mungesës së kuorumi, Asambleja mblidhet përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmëria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtesë ose kufizojnë / zvogëlojnë të drejtat që u janë njojur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut të interesuar/përkatës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori është përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.


Neni 11

Organ Administrues/Administratori

Organ Administrues përbëhet nga 1 (një) Administrator që emërohet e shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorëve është 5 (pesë) vjet, me të drejtë riemërimi.

Eduard Prodani, i biri i Luan-it, lindur më 18.06.1963 në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën: Rr. "Arkitekt Sinani", Nd. 56, H.10, Ap. 36, Njësia Administrative Nr. 3, 1005, Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal G30618108D, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Specimeni i administratorit:



Administratori do të :

- (i) administrojë veprimtarinë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- (ii) përfaqësoje Shoqërinë
- (iii) kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabël;
- (iv) përgatisë dhe nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për miratimin, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- (v) krijojë një sistem njoftimi të përshtatshëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (vi) kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
- (vii) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare si dhe përfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
- (viii) kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;



(ix) thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve sa herë që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13

Viti finansiar

Viti finansiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh e cila fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor te do viti.

Në mënyrë përjashtimore, viti i parë finansiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

Neni 14

Rezerva Ligjore

Shoqëria do të kalojë në fondin rezervë të detyrueshëm të paktën 5% (pesë përqind) të fitimit vjetor neto derisa kjo rezervë të arrijë vlerën e barabartë me 10 përqind të kapitalit themeltar.

Neni 15

Dividentet

Pas miratimit të bilancit vjetor dhe përcaktimit të shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve përcakton Shumën e fitimeve që do t'i shpërndahet secilit prej Ortakëve si dividend.

KAPITULLI V

PRISHJA-LIKUIDIMI

Neni 16

Prishja e Shoqërisë

Shoqëria prishet (i) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve; ose (ii) në rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimitari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) për arsyet tjetra të parashikuara në ligj.

Neni 17

Likuidimi

Me përjashtim të rastit të fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqërisë shoqërohet me fillimin e procedurës se likuidimit.



Neni 18


Dispozita Përfundimtare

Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet në lidhje me këtë Statut do të zgjidhen nga gjykata e rrëthit gjyqësor ku Shoqëria ka selinë e saj.

ORTAKËT THEMELUES

EDUARD PRODANI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Eduard Prodani". The signature is fluid and cursive, with a large, stylized "E" at the beginning. It is written over a few lines of horizontal ruling from a notebook.